

**STATUTI**  
**I**  
**SHOQERISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

Pjestarët e krijimit të Shoqërisë "MAXPHARM SH.P.K" të mbledhur sot më 12 Tetor 2020, bazuar në ligjin Nr 9901, datë 14.04.2008 " Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare ".

**KAPITULLI I**  
**EMERTIMI, OBJEKTI, SELIA, KOHEZGJATJA**

**NENI 1**

Ortakët themelues të Shoqërisë janë :

1. **ARGJENT TARANESHI** ,atësia Mentor, datëlindja 28/11/1961 lindur ne Dibër, Republika e Maqedonisë të Veriut, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i Pasaportës Nr.: KO186314, me Nr. Personal 2811961432001
2. **BURIM NAMANI**,atësia Ruzhdi, datëlindja 17/09/1986 lindur ne Orlan, Republika e Kosovës, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i Pasaportës me Nr.: P00990510 dhe Nr.Personal :1171979958
3. **SHENOL RIZVANÇE** ,atësia Ismail, datëlindja 27/06/1970, lindur në Gostivar, Republika e Maqedonisë të Veriut, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i Pasaportës Nr.:KO187614, me Nr. Personal 2706970473030
4. **SAMIR RIZVANÇE**, atësia Ismail, datëlindja 31/10/1972 , lindur në Gostivar, Republika e Maqedonisë të Veriut, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i Pasaportës Nr.:KO212993, me Nr. Personal 3110972473031

**NENI 2**  
**EMERTIMI**

Shoqëria tregtare private me Përgjegjësi të Kufizuar emërtohet „MAXPHARM“ SH.P.K e cila këtu e më poshtë do të quhet Shoqëria "MAXPHARM" SHPK.

**NENI 3**

Shoqëria krijohet në bazë të legjislacionit në fuqi të Republikës së Shqipërisë dhe si person juridik, e zhvillon aktivitetin në përputhje me këtë legjislacion dhe me normat e këtij Statuti.

**NENI 4**

Shoqëria e shtrin aktivitetin tregtar në të gjithë juridiksionin territorial të Republikës së Shqipërisë.

Me vendim të Asamblesë së Ortakëve, mund të krijohen ose anulohen (në rast se janë çelur) Filiale, Përfaqësi si në qytete të tjera të Shqipërisë dhe jashtë shtetit.

Njësitë e tjera strukturore të shoqërisë, si Degë apo Përfaqësi jashtë shtetit krijohen kur një gjë e tillë e parashikon dhe lejon edhe legjislacioni i vendeve të huaja, normat e së drejtës ndërkombëtare private dhe parimet e reciprocitetit tregtar mes vendeve të ndryshme.

**NENI 5**  
**SELIA E SHOQËRISË**

Selia e Shoqërisë do të jetë me adresë : **Rruga "Belul Hatibi 232, Njësia Administrative Nr 4, ZK 8130, Nr Pasurie 2/24, Vol 26, Faqe 47, Kutu Postare Nr 1000, Tiranë.**

Transferimi i selisë së Shoqërisë mund të bëhet me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

**NENI 6**  
**KOHEZGJATJA E VEPRIMTARISE**

Kohëzgjatja e Shoqërisë do të jetë me afat të pacaktuar. Ajo mund të shpërbëhet në cdo kohë dhe për çfarëdo lloj shkakut sipas kushteve të parashikuara në ligj.

Me vendim të Asamblesë së Ortakëve, kohëzgjatja e ushtrimit të aktivitetit të Shoqërisë mund të ndryshojë dhe ky vendim i dërgohet menjëherë për depozitim Qendrës Kombëtare të Biznesit, për të bërë shënimet e nevojshme në Regjistrin e Shoqërive Tregtare.

**NENI 7**  
**OBJEKTI I VEPRIMTARISË**

Import-Eksport, tregtim me shumicë i të gjitha llojeve të produkteve farmaceutike, pajisjeve kozmetike, suplemente ( shtesa ushqimore) dhe të tjera.

Cdo produkt cili i nënshtrohet ligjit të " Barnave dhe shërbimit farmaceutik", ligjit " Për Produktet Kozmetike " si dhe ligjit " Për Pajisjet mjekësore "

Për kryerjen e aktivitetit të shoqërisë së mesiperme, për të cilin do të nevojitet leje përkatëse, shoqëria është e detyruar të pajiset paraprakisht me këtë leje nga organi kompetent.

**NENI 8**

Me qëllim arritjen e objektivit të shoqërisë, ajo ka të drejtë të kryejë cdo aktivitet të nevojshëm e të dobishëm që ka lidhje me objektin e saj, duke përbushur të gjitha veprimet tregtare, për pasuritë e paluajtshme dhe të luajtshme, financiare dhe bankare.

**NENI 9**

Shoqëria e fiton personalitetin juridik nga dita e pajisjes me Çertifikatën e Identifikimit të Personit të Tatueshëm ( NIPT ) nga Qendra Kombëtare e Biznesit.

**KAPITULLI II**  
**KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, PJSËT DHE TRANSFERIMI I KUOTAVE**

**NENI 10**

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është **100 000 Lekë**, të ndarë në 4 (katër) kuota. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

1. Ortaku themelues **Argjent Taraneshi**,

Zoterues i një kuote me vlerë të përgjithshme që përben **30 % të kapitalit** themeltar të Shoqërisë.

2. Ortaku themelues **Burim Namani**,

Zoterues i një kuote me vlerë të përgjithshme që përben **30 % të kapitalit** themeltar të Shoqërisë.

3. Ortaku themelues **Shenol Rizvance** ,

Zoterues i një kuote me vlerë të përgjithshme që përben **20 % të kapitalit** themeltar të Shoqërisë.

4. Ortaku themelues **Samir Rizvance**

Zoterues i një kuote me vlerë të përgjithshme që përben **20 % të kapitalit** themeltar të Shoqërisë.

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta)

#### NENI 11

Kapitali themeltar është lirisht i transferueshëm tek personat e tretë, në qoftë se Asambleja e Përgjithëshme e Ortakëve vendosin për këtë.

Kapitali themeltar mund të lihet peng sipas legjislacionit në fuqi.

Kapitali themeltar është i transferueshëm në rrugë trashëgimie.

Bashkëshortja, paraardhësit dhe pasardhësit mund të bëhen ortakë nëpërmjet transferimit të pjesëve të kapitalit themeltar, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve dhe sipas kushteve që lejohen me ligj.

Transferimet e pjesëve të kapitalit themeltar duhet të vërtetohen me një akt noterial.

#### NENI 12

Pjesët e kapitalit themeltar, janë në likuiditet, nominative dhe lirisht të transferueshme në mes të ortakëve sipas dispozitave të Kodit Civil.

Ortakët kanë të drejtën e parablerjes së kuotave ndaj njëri tjetrit.

Ortakët gëzojnë gjithashtu të drejtën e shitjes apo transferimit të kuotave që zotërojnë, personave të tjerë fizikë apo juridikë, jashtë ortakërisë, vendas ose të huaj, vetëm atëherë kur asnjëri prej tyre nuk ushtron të drejtën e parablerjes.

Shitja apo tranferimi i kuotave tek Ortakët dhe të tretët bëhet me akt noterial.

#### NENI 13

##### TRANSFERIMI I KUOTAVE

Ortakët , secili prej tyre, ka të drejtë të transferojë jashtë territorit të RSH pjesërisht apo tërësisht kontributet e tij përfshirë dhe Fondet e Kontributet në Natyrë bazuar në të drejtën që parashikon dhe lejon ligji “Për investimet e Huaja”

Transferimet e pjesëve të Kapitalit themelor duhet të jenë të vërtetuara me Akt Noterial dhe për një gjë të tillë Ortakët duhet të marrin paraprakisht vendim me shkrim.

Shoqëria dhe të tretët, duhet të respektojnë këto transferime sapo të bëhen të ditura.

#### NENI 14

Në cdo rast, transferimi në cdo lloj forme, si me shpërblim ashtu dhe pa shpërblim në kuptim më të gjerë të fjalës, duke përfshirë këtu edhe dhurimin në favor të subjekteve të tjerë të ndryshëm nga Ortakët, kuotat duhet më parë t'i ofrohen në parablerje ortakëve të tjerë.

Në një rast të tillë Ortaku që do të transferojë kuotën duhet të njoftojë ortakët e tjerë me letër rekomande me kthim përgjigje, mbi synimin për shitje, duke përcaktuar cmimin, kushtet, modalitetet, emrin e blerësit dhe afatet e transferimit. E drejta e Parablerjes duhet t'i referohet të gjithë kuotës të ofruar për shitje.

Ortakët do të kenë në dispozicion 15 (pesëmbëdhjetë)ditë nga marrja, e letrës rekomande, për t'i komunikuar ortakut që transferon kuotat, synimin e tyre për të ushtruar apo jot ë drejtën e parablerjes. Në rast se ata nuk përgjigjen në afatin e caktuar, prezumohet se kanë hequr dorë nga e drejta e tyre parablerjes.

Në rast se oferta pranohet nga disa ortakë, kuota e ofruar nga ortaku që transferon atë, do të ndahet midis ortakëve pranues, në të njëjtën masë me vlerën nominale të kuotës së kapitalit që ata zotërojnë, përvec rastin kur ka një marrëveshje të kundërt. Në asnjë rast, pranuesi i ofertës nuk mund të ushtrojë pjesërisht të drejtë e parablerjes.

Në rast se nuk ushtrohet e drejta e parablerjes, kuotat mund t'u transferohen të tretëve plotësisht apo pjesërisht, me vendim pozitiv të Asamblesë së Ortakaëve.

#### NENI 15

##### TJETËRSIMI I KUOTAVE

Për tjetërsimin e kuotave në vlerën e kontributit të kapitalit themeltar, secili ortak është i detyruar të njoftojë me shkrim shoqërinë, e cila brenda 1 muaj nga dita e njoftimit, duhet të marrë vendim me shkrim për lejimin e transferimit.

Ky vendim merret me shumicën e votave Pro, të Asamblesë së Ortakëve që zotërojnë pjesët e kapitalit themeltar.

Kur Asambleja e Ortakëve me kalimin e 30 ditëve nuk merr vendimin përkatës për miratimin ose jo të kërkesës së njërit ortak për tjetërsimin e kuotave të tij, kërkesa quhet e pranuar.

Kur në mbledhjen e saj asambleja e ortakëve merr vendim për pranimin e kërkesës nga ortaku që e ka bërë atë, ka të drejtën e shitjes dhe transferimit të kuotave që ai zotëron.

Në rast se asambleja e ortakëve merr vendim për refuzimin e kërkesës për shitjen apo transferimin e kuotave, çdo ortak brenda 30 ditëve, duhet të ushtrojë të drejtën e parablerjes së kuotave, në të kundërt, me plotësimin e këtij afati ortaku kërkues mund ti shesë apo transferojë kuotat e tij tek të tretët, brenda vendit apo jashtë shtetit.

Kur lind nevoja e vlerësimit të kuotave, Ortakët marrin vendim me shkrim për caktimin e një eksperti kontabël të autorizuar dhe kur nuk bien dakord për një gjë të tillë, ja kerkojnë caktimin e tij Gjykatës së juridiksionit përkatës, vendimi i të cilës është i detyrueshëm, pasi të ketë marrë formën e prerë.

**NENI 16**  
**LLOGARIA BANKARE**

Shoqëria çel llogari bankare në lekë dhe çdo lloj valute, në banka vendase ose të huaja, private apo shtetërore, me qëllim për të kryer veprimet e nevojshme për ushtrimin dhe përballimin financiar të aktivitetit të saj.

Administrator/ Administratorët caktuar në Aktin e themelimit dhe Statutin e Shoqërisë, depoziton specimentin e firmës origjinale në bankat ku do të çelen llogaritë e Shoqërisë.

Veprimet bankare kryhen me firmën e Administratorit/ Administratorëve, për veprimtarinë e zakonshme financiare, kryerjen e pagesave, likuidimeve me furnitorët jashtë e brenda vendit të detyrimeve fiskale shtetërore si tatimore, doganore, sigurimeve shoqërore e shëndetësore, pagat e punonjësve, pagesat e sipas Kontratave të Shërbimit apo të furnizimit, TVSH etj.

**NENI 17**

Në rastet e kryerjes së veprimtarive të rëndësishme që kanë të bëjnë me vënie në garanci hipotekore, ato për marrje kredie, ose cdo formë tjetër huamarjeje do të kryhen vetëm mbi bazën e vendimit me shkrim të Mbledhjes së Asamblesë së Ortakëve dhe me nënshkrimin e tyre.

**NENI 18**

Fushat e autoritetit të ortakëve dhe përqindja e fitimeve ose e humbjeve do të kenë si kriter bazë kapitalin e Shoqërisë si dhe kompetencat që gëzojnë ortakët në marrjen e vendimeve të çdo karakteri, të përcaktuara në këtë Statut.

**NENI 19**

Kapitali themeltar i shoqërisë mund të rritet ose të zvogëlohet mbi bazën e vendimit me shkrim të marrë unanimisht në mbledhjen e Asamblesë së Ortakëve, i cili nënshkruhet prej tyre dhe dokumentohet duke bërë dhe shënime në regjistrin përkatës.

Me vendim të Asamblesë së Ortakëve, në dizpozicion të Shoqërisë mund të vihen dhe fonde të tjera financiare duke përfshirë dhe shtesa me anë të Kapitalit në Natyrë.

**NENI 20**  
**ZMADHIMI I KAPITALIT THEMELTAR**

Zmadhimi i kapitalit themeltar, mbi bazën e vendimit me shkrim të Asamblesë së Ortakëve bëhet kur më parë secili ortak ka deklaruar, nënshkruar dhe derdhur vullnetarisht pjesën e kapitalit që kërkon të zmadhojë, si në formën e kontributit në valutë ose lekë dhe në natyrë.

Kapitali themeltar zmadhohet nëpërmjet emetimit të aksioneve të reja ose nëpërmjet rritjes së vlerës nominale të aksioneve ekzistuese.

Aksionet e reja shlyhen me para në dorë ose me kontribut në natyrë.

Nuk konsiderohen zmadhim i kapitalit themeltar kontributet e shërbimeve të secilit ortak.

Pas marrjes së vendimit për zmadhimin e kapitalit themeltar, Ortakët duhet të marrin vendim me shkrim dhe për të pasqyruar një rrethanë të tillë në aktin e themelimit dhe Statutin e Shoqërisë duke pasqyruar qartë kuotat apo kontributin e derdhur nga secili ortak.

#### **NENI 21**

Vendimet me shkrim të Ortakëve, për zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit themeltar, duhen të pasqyrohen dhe në Statut pasi të jenë legalizuar për bazueshmërinë ligjore dhe autenticitetin e nënshkrimeve para një noteri.

Ato dërgohen menjëherë për depozitim në QKB, për të bërë shënimet e nevojshme në Regjistrin Tregtar të Shoqërive Tregtare.

#### **NENI 22**

##### **ZVOGELIMI I KAPITALIT FILLESTAR**

Zvogëlimi i kapitalit themeltar mund të bëhet vetëm me Vendim të Asamblesë së Ortakëve. Në cdo rast kapitali themeltar nuk mund të zvogëlohet nën kufijtë e parashikuar me ligj.

Zvogëlimi I kapitalit përbalohet nga secili prej Ortakëve në të njëjtën masë me vlerën nominale të kuotës së kapitalit të zotëruar prej tyre.

Në rastin kur Asambleja e Ortakëve vendimin për zvogëlimin të kapitalit themeltar e merr për shkakun se humbjet e Shoqërisë arrijnë nën limitin e parashikuar dhe lejuar nga Kodi Tregtar për Shoqëritë me Ortakëri me Përgjegjësi të Kufizuar, krahas vendimit për zvogëlimin e kapitalit themeltar, Ortakët duhet të marrin vendim dhe për të përcaktuar:

- 1-Nevojën e ndryshimit të formës juridike të shoqërisë duke kaluar në një formë tjetër.
- 2-Ndryshimin e aktit të themelimit dhe të statutit të saj.
- 3-Të bëjnë publikimin dhe njoftimin e të tretëve , me të cilët Shoqëria ka marrëdhënie kontraktore si dhe të kreditorëve të saj.

#### **KAPITULLI III**

##### **ORGANET DREJTUES TE SHOQËRISË DHE TE DREJTAT DHE DETYRAT E ORTAKËVE**

#### **NENI 23**

Organet drejtuese të shoqërisë janë :

- 1.Asambleja e Ortakëve
- 2.Administratori / Administratorët e Shoqërisë.

#### **NENI 24**

Mbledhja e asamblesë së ortakëve është organi i vetëm më i lartë drejtues e vendimmarrës i Shoqërisë dhe ushtron të gjitha kompetencat që i njeht ligji "Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

Asambleja e Ortakëve përbëhet nga Ortakët themelues të Shoqërisë.

Ortakët kryejnë drejtimin dhe administrimin e Shoqërisë, duke respektuar legjislacionin tregtar në fuqi si dhe të drejtat dhe detyra e përcaktuar në Aktin e Themelimit dhe këtë Statut.

#### NENI 25

Me vendim të Asamblesë së Ortakëve, Shoqëria mund të zgjerohet duke pranuar një ose më shumë ortakë të tjerë, shtetas shqiptar apo të huaj, ose bashkohet me një shoqëri tjetër tregtare si brenda vendit dhe jashtë vendit, të zgjerojë objektin e veprimtarisë së saj etj.

#### NENI 26

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve është organi me i lartë i Shoqërisë dhe vendos për cdo ceshtje. Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme janë detyruese për të gjithë Ortakët.

Vetëm Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve ka të drejtën e vendimeve lidhur me :

- ndryshimit të Statutit, në lidhje me gjithë dispozitat e saj;
- të emërojë ose të shkarkojë Administratorin/ Administratorët ,
- zmadhim ose zvogëlim të kapitalit
- transferim të kuotave
- shpërndarje të fitimeve
- riorganizim ose prishja e shoqërisë
- mirartimin e bilancit dhe për cdo vendim tjetër parashikuar nga ky Statut apo legjislacioni përkatës.

Cdo veprim tjetër konsiderohet i pavlefshëm.

#### NENI 27

Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme në rast se Ortakët ose Ortakët e përfaqësuar përbëjnë të paktën 2/3 të kapitalit aksionar. Në rast se nuk ekziston shumica e duhur e mësipërme, Asambleja e Përgjithshme mund të anulohet për një ditë tjetër.

Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve merren me shumicën absolute të 2/3 të votave ose të votave të përfaqësuar.

#### NENI 28

Cdo Ortak mund të përfaqësohet vetëm nga një Ortak tjetër ose nga një person tjetër i Autorizuar prej tij, por gjithmonë vetëm nëpërmjet një Akti Noterial.

#### NENI 29

Ortakët e shoqërisë kanë dhe këto të drejta dhe detyra kryesore:

- Të marrin pjesë në drejtimin dhe administrimin e gjithanshëm të veprimtarisë ekonomiko-tregtare të shoqërisë dhe të çdo veprimtarie tjetër të saj, kur ajo ushtrohet në përputhje me ligjet, Aktin e Themelimit dhe Statutin e saj.
- Të kërkojnë dhe ti jepen të gjitha informatat që kanë të bëjnë me gjendjen tregtare dhe financiare të veprimtarisë së shoqërisë, si dhe i të gjitha dokumentave të përpunuara nga

Shoqëria , ato që kanë të bëjnë me nxjerrjen e rezultatit ekonomik të bilancit kontabël apo për çdo llogari të çelur, si dhe të asaj likuiduese sipas kontributit të dhënë prej tij.

- Të kryejnë shërbime për realizimin e objektivave dhe qëllimeve të veprimtarisë së rregullt e ligjore të shoqërisë.
- Me vendim të asamblesë, Ortakët emërojnë dhe shkarkojnë në çdo kohë administratorin e shoqërisë.
- Mundësohen për të kryer të gjitha aktet dhe veprimet juridike që konsiderohen se janë të domsdoshme për ushtrimin e gjithanshëm dhe fitim prurës të veprimtarisë tregtare të shoqërisë sipas qëllimeve dhe objektivave të saj.

#### **NENI 30**

Përfaqësimi i shoqërisë, në marrëdhëniet me të tretët si brenda vendit dhe jashtë shtetit si rregull dhe përgjithësisht ju përket Administratorit / Administratorët.

#### **NENI 31**

Ortakët ushtrojnë të gjitha kompetencat që u njihen me ligj për shkak të kësaj cilësie.

#### **NENI 32**

##### **KOMPETENCAT E ORTAKËVE**

Për sa kohë që Shoqëria do të përbëhet nga 4 ortakë, kompetencat e tyre do të jenë:

- Vendosin për ndryshimet në Statutin e Shoqërisë dhe përpilojnë ose miratojnë rregulloret për Shoqërinë apo për sektorë të veçante të veprimtarisë.
- Vendosin për zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit dhe transferimin e pjesëve të kapitalit.
- Vendosin për politikën afariste të Shoqërisë dhe përcaktojnë fushat konkrete të veprimtarisë së saj.
- Emërojnë dhe shkarkojnë Administratorin / Administratorët e Shoqërisë dhe detajojnë kompetencat e tyre të percaktuara në statut.
- Shqyrtojnë bilancin vjetor, përcaktojnë llojet e fondeve të ndryshme dhe masën e tyre, fitimin e realizuar si dhe vendosin për marrjen e kredive.
- Vendosin për krijimin e degëve (filialeve) ose të përfaqësive si dhe për krijimin e shoqërive me persona të tjerë fizikë apo juridikë.
- Vendosin për marrëdhëniet më të rëndësishme ekonomike dhe financiare të Shoqërisë me persona të tjerë fizikë apo juridikë, vendas apo të huaj.
- Vendosin për mbarimin e Shoqërisë, likuidimin e saj si dhe për shndërrimin e Shoqërisë nga shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në shoqëri të formave të tjera.

#### **NENI 33**

##### **ADMINISTRATORI**



Administratori/Administratorët e Shoqërisë, i/të emëruar prej Asamblesë së Ortakëve kanë të drejtë që për nevojat e ushtrimit normal të aktivitetit të Shoqërisë, të marrin në punë specialistë dhe shtetas të ndryshëm madhorë dhe me zotësi të plotë për të vepruar, duke e lidhur Kontratën sipas kritereve që parashikohen në Kodin e Punës në fuqi, të miratuar me Ligjin Nr.7961 dt 12/07/1995 dhe shtesat e mëpasme plotësuese të tij dhe me Ligjin Nr. 7703 dt 11/05/1993 "Për Sigurimet Shoqërore" si dhe në përputhje me rregullat teknike dhe të disiplinës profesionale të caktuara nga ana e punëdhënësit.

#### NENI 34

Shoqëria administrohet nga të paktën 1 ( një) Administrator I cili do të qëndrojë në detyrë deri në shkarkim apo dorëheqje për një periudhë 5 ( pesë) vjecare .  
Administratori do të emërohet nga Asambleja më votën unanime të të gjithë ortakëve.

#### NENI 35

##### KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT

Kompetencat e Administratorit ose të Administratorëve, në mënyrë konkrete dhe të detajuar përcaktohen në aktin e tyre të emërimit. Veç të tjerave që mund të detajohen në këtë akt, administratori ka edhe këto kompetenca:

- Realizon administrimin, drejtimin dhe përfaqësimin e Shoqërisë në marrëdhëniet me persona të tjerë juridikë apo fizikë.
- Kujdeset për funksionimin e përditshëm normal të Shoqërisë ose të një pjese të aktivitetit ekonomik dhe financiar të saj, sipas përcaktimit në aktin e emërimit.
- Përgatit dokumentacionin dhe raportet e ndryshme për gjendjen ekonomike dhe financiare të Shoqërisë sipas legjislacionit në fuqi dhe ua paraqet Ortakëve të Shoqërisë për shqyrtim.
- Koordinon veprimtarinë e personave të punësuar në Shoqëri.
- Shqyrton ofertat dhe përgatit kërkesa.
- Ndjek problemet e Shoqërisë në marrëdhënie me organet shtetërore ose cakton ndonjë prej personelit për trajtimin e këtyre problemeve.
- U propozon Ortakëve rregulloret për sektorë të veçantë të Shoqërisë.
- Ka të drejtë të emërojë Ekspertin Kontabël
- Ka të drejtë të punësojë personel sipas nevojave të shoqërisë dhe Legjislacionit në fuqi dhe të përcaktojë pagën e tyre
- Të përcaktojë likuidatorët.
- Të vendosë cmimin e mallrave

Administratori/ Administratorët është/janë përgjegjës ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve qoftë për shkelje ligjore, qoftë për shkelje të statutit ose për faje të kryera gjatë administrimit të tij. Kompetencat e administratorit janë të kufizuara sipas këtij Statuti.

#### NENI 36

Administratori mund të emërojë përfaqësues të posacëm për veprime apo kategori të caktuara veprimesh.

### KAPITULLI IV BILANCI, TE ARDHURAT DHE SHPËRNDARJA E SHOQËRISË

#### NENI 37

Veprimet ekonomiko-financiare të Shoqërisë, mbyllen me datën 31 Dhjetor të çdo viti.

Nxjerrja e Bilancit financiar vjetor, bëhet duke respektuar rregullat mbi Kontabilitetin dhe brenda datës 31 Mars të vitit pasardhës, nga data e mbylljes së vitit financiar.

Për nxjerrjen e rezultatit Kontabël të Shoqërisë, mbi bazën e Aktivit dhe Pasivit me vendim të Administratorit / Administratorëve caktohet një Ekspert Kontabël i Autorizuar.

#### NENI 38

Eksperti ka për detyrë të kontrollojë dhe verifikojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë Ekonomiko Tregtare të Shoqërisë, si atë vjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij, për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë mbi bazën e Vendimit të marrë nga Administ. Atori / Administratorët

Në përfundim të Kontrollit, Eksperti Kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit përfundimtar të Bilancit Financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë dhe dorëzojë në kohë Mbledhjes së Asamblesë së Ortakëve, i cili është Organi i vetëm për ti shqyrtuar dhe vendosur miratimin e tij.

#### NENI 39

Nxjerrja e rezultateve të Bilancit vjetor, duhet bërë me saktësi dhe duke respektuar të gjitha rregullat që përcaktohen në Ligjin mbi kontabilitetin dhe atyre të sistemit të Tatim Taksave që janë të detyrueshme për tu zbatuar nga çdo subjekt privat që ushtron veprimtari tregtare.

Eksperti Kontabël i autorizuar përveç të drejtave, ka edhe këto detyrime:

- Garanton Asamblenë e Ortakëve se llogaritë vjetore janë të rregullta dhe Bilanci është nxjerrë me saktësi dhe konform rregullave të Ligjit "Mbi Kontabilitetin".
- Të pasqyrojë me vërtetësi rezultatet e operacioneve të vitit të kaluar financiar dhe gjëndjen reale financiare të Shoqërisë në mbylljen e vitit financiar të aktivitetit tregtar të saj.
- Të verifikojë përputhjet me llogaritë vjetore të informacioneve të dhëna nga Administratorët e Shoqërisë në Mbledhjet e Asamblesë se Ortakëve, duke përfshire dhe

dokumentat për gjëndjen financiare që ai (Administratori) i ka paraqitur Asamblesë së Ortakëve.

- T'i bëjë të njohur Ortakëve dhe Administratorit të Shoqërisë: Kontrollat dhe verifikimet që janë bërë prej tij për kontrolle periodike ose vjetore, duke vënë në dukje parregullsitë apo pasaktësitë e konstatuara, masat ligjore për rregullimin e tyre, etj.

#### NENI 40

Eksperti Kontabël i autorizuar është përgjegjës ndaj Shoqërisë dhe ndaj të tretëve për pasojat e dëmshme të shkaktuara me fajin e tij (Dashje ose pakujdesi) aktivitetit tregtar të Shoqërisë, por nuk është përgjegjës kur këto Dëme shkaktohen pa dijeninë e tij dhe nga veprimet me faj të Administratorit të Shoqërisë.

#### NENI 41

Bilanci Kontabël vjetor, miratohet mbi bazën e vendimit me shkrim të marrë nga Ortakët në mbledhjen e asamblesë së ortakëve, në të cilën jo vetëm që dokumentohet aprovimin e tij por dhe që përcakton dhe në lidhje me disponibilitetin e fondeve ligjore, sipas nevojave të zhvillimit të mëtejshëm të aktivitetit të shoqërisë por dhe për garantimin e veprimtarisë së rregullt të saj, duke patur parasysh Fondin e Akumulimit, krijimin e fondit të veçantë, etj.

#### NENI 42

Për formimin e fondit rezervë, që emërtohet "Rezervë e domosdoshme" Ortakët vendosin që nga fitimi i akumuluar gjatë vitit financiar, pasi zbriten humbjet e vitit të mëparshëm, të lërë të paktën 1/20 e vlerës së Fitimit të realizuar.

#### NENI 43

Të ardhurat neto ( dividenti ) që mbeten pas veçimit të fondeve ligjore të mësipërme dhe të atyre për shlyerjen e çdo detyrimi tatimor e fiskal apo likuidimin e pagesave ose ekzekutimin e detyrimeve (debive) ndaj të tretëve, i kalojnë në pronësi, Ortakëve në raport me përqindjen e Kontributit financiar që ata kanë dhënë në krijimin e Kapitalit Themeltar.

#### NENI 44

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë, mund të bëhet në çdo kohë dhe për çfarëdo shkak, siç mund të jenë:

- a) Humbja e Kapitalit ose pamundësia e vazhdimit të mëtejshëm të veprimtarisë së saj.
- b) Në një nga mënyrat e parashikuara nga Ligji " Për Falimentimin e Shoqërive Tregtare "
- c) Me kërkesën e njërit Ortak dhe kur kjo pranohet nga Mbledhja e Asamblesë së Ortakëve.

Në këtë rast Ortakët, marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë dhe mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke autorizuar Administratorin / Administratorët të caktojë një apo disa likuidatore duke lëshuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtesë "Shoqëri në likuidim e sipër".

#### NENI 45

Akti i emërimit të likuidatorit, publikohet sipas kushteve që parashikon ligji përkatës duke specifikuar dhe dokumentat që duhen depozituar në aneksin e regjistrit Tregtar.

#### NENI 46

Likuidatori është i detyruar që të jetë i vëmendshëm dhe korrekt si për realizimin e të drejtave për subjektet ndaj të cilave Shoqëria është Kreditore dhe për ekzekutimin e plotë të detyrimeve (debive) që Shoqëria ka ndaj shtetit, shtetasve të veçantë, apo personave fizike ose juridike vendas apo të huaj.

#### NENI 47

Për të saktësuar veprimtarinë e saj ekonomike si dhe marrëdhëniet e punës, Shoqëria do të çelë librin e vet i cili do të quhet Libri i Shoqërisë.

#### NENI 48

##### DOKUMENTET E DESTINUARA PËR TË TRETËT

Të gjitha aktet dhe dokumentat që nxirren nga Shoqëria dhe janë të destinuara për të tretët, si letrat, faturat, lajmërimet, publikimet e ndryshme etj., duhet të tregojnë lexueshëm emrin e Shoqërisë dhe pas tij fjalët "Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar" ose inicialet "SH.P.K", si dhe emrin e administratorit.

#### NENI 49

Shoqëria është e detyruar të mbajë përveç Librit të Shoqërisë, në të cilin shënohet emri i plotë i ortakëve, kapitali themeltar, si dhe vendimet e ortakëve të Shoqërisë edhe dokumentacionin kontabël dhe librat e tjerë.

#### NENI 50

Çdo mosmarrëveshje apo konflikt që mund të lindë gjatë ushtrimit të veprimtarisë së shoqërisë si rregull dhe përgjithësisht Ortakët duhet ta zgjidhin në mirekuptim në të kundërtën çështjen mund ta bëjnë objekt konflikti gjyqësor.

Të drejtën e ngritjes së Padisë gjyqësore, në rast konflikti civil, çdo Ortak e disponon në mënyrë të pavarur, duke e ngritur atë në Gjykatën kompetente

#### NENI 51

Përsa nuk është shprehur në këtë Statut i referohet udhëzimeve plotësuese e konform akteve ligjore e nënligjore në fuqi, të dhëna nga ana e Ortakëve të Shoqërisë si dhe hapësirave juridike lejuese të Legjislacionit në fuqi dhe normave ndërkombëtare.

#### NENI 52

Përsa nuk është shprehur në këtë Statut i referohet udhëzimeve plotësuese e konform akteve ligjore e nënligjore në fuqi, të dhëna nga ana e Ortakëve të Shoqërisë si dhe hapësirave juridike lejuese të Legjislacionit në fuqi dhe normave ndërkombëtare.

#### NENI 53

##### DISPOZITA E FUNDIT

Pasuria e Shoqërisë mund të sigurohet në ndonjë Institut Sigurimi si brenda ashtu edhe jashtë Shqipërisë.

Shoqëria do të ketë vulën e saj, forma dhe madhësia e së cilës do të përcaktohen nga Administratori / Administratorët.

Administratorë të shoqërisë do të jenë

**1. Z.BURIM NAMANI**

Ata e ushtrojnë këtë detyrë për një periudhë 5 (pesë) vjecare me të drejtë rizgjedhje sipas miratimit të ortakëve.

Ky Statut është hartuar në 6 (gjashtë) kopje, në gjuhën shqipe, duke patur secila fuqi të njëjtë ligjore dhe pasi lexohet në parim dhe nën për nën nga Ortakët themelues të Shoqërisë MAXPHARMA Shpk nënshkruhet prej tyre në të gjitha kopjet duke u vënë emri, mbiemri dhe firma origjinale.

Tirane , me 12.10.2020

**ORTAKET THEMELUES**


**Z. ARGJENT TARANESHI**



**Z. BURIM NAMANI**



**Z. SHENOL RIZVANÇE**



**Z. SAMIR RIZVANÇE**

